

AKT THEMELIMI
DHE
STATUTI I SHOQERISE

“ B2G MEDICAL PLANTS ” SH.P.K

Sot me date 08.02.2019 ,

- BIAGIO MANCUSO, atesia(GAETANO), shtetas italian, lindur me 12.06.1979, ne CROTONE (KR), Itali dhe banues ne CROTONE, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr.YA1233330
- GIAMBATTISTA LONGO,atesia(DOMENICO), shtetas italian, lindur me 12.09.1985, ne COSENZA (CS), Itali dhe banues ne CLETO (CS) , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr.YB2180914
- GIOVANNI IACONETTI ,atesia(FRANCESCO), shtetas italian, lindur me 24.02.1980, ne LAMEZIA TERME (CZ), Itali dhe banues ne AMANTEA(CS) , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr.YA4574037

bazuar, ne legjislacionin ne fuqi vecanerisht, bazuar ne nenet 68 e vijues te ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 «Per Shoqerite Tregtare» i ndryshuar me ligjin nr. 129/2014 , Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 ”Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, LIGJ Nr. 131/2015 PER QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT, ne dispozitat e Kodit Civil ne cilesine e ortakeve themelues si dhe ne vullnetin tone te lire te shprehur dhe ne nenshkrimin e akteve te themelimit te shoqerise kemi hartuar aktin e themelimit dhe statutin e nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar (me poshte shoqeria):

KREU I

THEMELIMI , EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA

NENI. 1

DATA E THEMELIMIT, EMRI I THEMELUESIT

1. Sot ne date 08.02.2019, u themelua shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin

“B2G MEDICAL PLANTS” SH.P.K

2. Themeluesit e shoqerise jane :

- BIAGIO MANCUSO, atesia (GAETANO), shtetas italian, lindur me 12.06.1979, ne CROTONE (KR), Itali dhe banues ne CROTONE (KR), madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr.YA1233330
- GIAMBATTISTA LONGO,atesia(DOMENICO), shtetas italian, lindur me 12.09.1985, ne COSENZA (CS), Itali dhe banues ne CLETO (CS) , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr.YB2180914
- GIOVANNI IACONETTI ,atesia(FRANCESCO), shtetas italian, lindur me 24.02.1980, ne LAMEZIA TERME (CZ), Itali dhe banues ne AMANTEA(CS) , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr.YA4574037



NENI. 2

OBJEKTI I SHOQERISE

Objekt i kesaj shoqerie do te jete:

1. Kompania do të ndërmarrë aktivitete bujqësore të cdo lloji, duke përfshirë kultivimin, transformimin e produkteve bujqësore dhe marketingun e tyre, në tokë në pronësi apo qira apo kultivim tjetër për sfarëdo produkti, blerjen e pajisjeve dhe makinerive të nevojshme për të objekt social, rezervat kafshesh shtepiake dhe cdo aktivitet tjetër i lidhur me aktivitetin zooteknik ne teresi .
2. Aktivitet ne sektoret merceologjik, farmaceutik, kimik, prodhim dhe tregtim te pesticideve te ndryshme te lidhur me aktivitetin kryesor te shoqerise.
3. Aktivitet me blerjen, shitjen dhe dhenien me qera te autoveturave te ndryshme.
4. Konsulence te pergjithshme.
5. Blerje, shitje, madje edhe fraksionimi, ristrukturimi dhe projektim, të gjitha aktivitetet e vlerësimit të pasurive të patundshme në përgjithësi, si urbane edhe rustike, për përdorim tregtar, industrial, rezidencial dhe zyra, dhe ekspertizat e vleresimet e tyre, dhënia me qira dhe menaxhimin i pasurive te paluajtshme.
6. Realizimi i Punimeve te ndertimit ne pergjithesi, punime te rrugeve perfshire gërmimet, shkaterimet, ndertimi i ujesjellesave, kanalizimeve dhe të ngjashme me to.
7. Ndertimi, instalimi, mirembajtja, shitja me shumice dhe pakice,importimi i sistemeve dhe instalimeve elektrike, hidraulike,civile dhe industriale, te prodhimit dhe shperndarjes se energjise elektrike, ngrohjes, kondicionimit, ftohjes dhe energjise alternative, objekteve te transportit.
8. Investimi ne tregun e ndertimit, blerje, administrim, shitje te pasurive te paluajtshme Real Estate.
9. Tregtim me shumice dhe pakice, Import eksport te produkteve, materialeve te ndertimit dhe makinerive te ndryshme te domosdoshme per ushtrimin e aktivitetit perfshire produktet bujqesore dhe ushqimore ne teresi .
10. Ushtrimi i aktivitetit brenda dhe jashte Shqiperise, ne perputhje me legjislacionin.
11. Cdo aktivitet tjetër te lidhur me aktivitetin kryesor

Per te gjitha aktivitetet qe kerkojne licenca te vecanta shoqeria do te angazhohet qe tani per te plotesuar kerkesat e ligjeve te posacme.

NENI. 3

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise do te jete deri ne nje afat te papercaktuar
Shoqeria mund te priset perpara ketij afati me vendim te asamblese se Ortakeve.

NENI. 4

SELIA E SHOQERISE

Selia e Shoqerise .eshte ne adresen: Bulevardi Deshmoret e Kombit, Qendra e Biznesit
"Kullat Binjake" kati 2, nr. 26 Tirane.



KREU II
KAPITALI
NENI. 5

KAPITALI I REGJISTRUAR

Kapitali i regjistruar i shoqerise do te jete 1000 (njemije) leke i perbere nga 3 (tre)kuota, i cili eshte i nenshkruar teresisht.

Pjesemarrja e ortakeve themelues ne kapitalin e shoqerise eshte:

Kontributi ne kapitalin e shoqerise zoterohet ne masen

- **BIAGIO MANCUSO**, atesia (**GAETANO**), shtetas italian, lindur me 12.06.1979, ne **CROTONE (KR)**, Itali dhe banues ne **CROTONE (KR)**, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr.YA1233330 zoteron 33% te kapitalit te shoqerise me vlere nominale 330 leke.
- **GIAMBATTISTA LONGO**,atesia(**DOMENICO**), shtetas italian, lindur me 12.09.1985, ne **COSENZA (CS)**, Itali dhe banues ne **CLETO (CS)** , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr.YB2180914 zoteron 44% te kapitalit te shoqerise me vlere nominale 440 leke.
- **GIOVANNI IACONETTI** ,atesia(**FRANCESCO**), shtetas italian, lindur me 24.02.1980, ne **LAMEZIA TERME (CZ)**, Itali dhe banues ne **AMANTEA(CS)** , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr.YA4574037 zoteron 23% te kapitalit te shoqerise me vlere nominale 230 leke.

Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme, apo te drejta).

NENI. 6

ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit te regjistruar per kontribute ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin e regjistruar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi prek ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqsojne.

NENI. 7

TRANSFERIMI I KAPITALIT



- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter percaktuar ne ligj.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme midis ortakeve.

Pjeset e kapitalit te regjistruar jane te transferueshme me rruge trashegimije, sipas parashikimeve ligjore.

KREU III ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE NENI. 8

ORGANET VENDIMARRESE

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmares i shoqerise.

Asambleja e pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet si me poshte:

- a. Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise
 - b. Ndryshimet e statutit
 - c. Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
 - d. Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
 - e. Percaktimi i shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c) e d)
 - f. Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
 - g. Miratimi,i bilanceve
 - h. Zmadhim dhe zvogelim kapitali
 - i. Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre
 - j. Perfaqesimin ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
 - k. Riorganizimi dhe prishja e shoqerise
 - l. Miraton rregulla proceduriale te mbledhjeve te asamblese
 - m. Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti
- Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

NENI 9 THIRRJA E MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortakët jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullslse.



NENI 10
KUORUMI

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket, qe zoterojne me shume se 30 % te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualiflkuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregetaret dhe Shoqerite tregetare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese kuorumi i permendur ne paragrafin e mesiperm nuk arrihet, asambleja e pergjithshme, mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

NENI 11
MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e pergjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave te zoteruesve te kapitalit te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statusit zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizmin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtjen te tjera.

Cdo ndryshim duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne regjistrin e shoqerise.

NENI 12
PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES


Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendimin pet:

- a) vleresmin e veprimtarise se tij
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- c) ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konfikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

NENI 13
ADMINISTRIMI

Asambleja e pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet me te drejte riprteritje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne QKB.



5

Personi i meposhtem caktohet si Administrator i pare i shoqerise, duke patur te drejta te pakufizuara administrimi:

- **GLAMBATTISTA LONGO**, atesia(DOMENICO), shtetas italian, lindur me 12.09.1985, ne COSENZA (CS), Itali dhe banues ne CLETO (CS), madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr.YB2180914

NENI 14

KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen te:

- a) Kryejne te gjltha veprimet e administrimit te vendosura nga asambleja e pergjithshme duke zbatuar politikat tregetare
- b) Perfaqesojne shoqerine
- c) Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise
- d) PergatIsIn dhe nenshkruajne bilancIn vjetor, bilancIn e konsoliduar dhe raportIn e ecurlse se veprImtarlse dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, I paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratIm
- e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhena e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit
- g) Raportojne para Asamblese se Pergjithshme nepermjet relacioneve mbi zbatimin e politikave tregetare dhe te veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise
- h) Kryejne detyra te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti.

Asambleja e pergjithshme mundet ne cdo moment, te shkarkoje administratorin me shumice te thjeshte te votave. Statuti ose rregullore te tjera nuk mund ta kufizojne ose heqin kete te drejte.

NENI 15

PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

1. Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate admInIstrImIt te shoqerise. Administratoret te cilet kane kryer veprIme ose bere marreveshje te pa aprovuara nga asambleja, jane pergjegjes per demet e sjella shoqerise dhe pergjigjen personalisht ose solidarisht per pasojat.
2. Nese administratori vepron ne kundershtrim me detyrat dhe shkel standartet profesionale eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e



shkeljes si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregulta.

KREU IV
VITI FINANCIAR -EKSPERTET
NENI 16
VITI FINANCIAR

Viti finaciar i Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 Dhjetor, Perjashtimisht , viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllet me 31 dhjetor.

NENI 17
EKSPERTET

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjitha dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko-tregtare te shoqerise, dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve. Ne permbushje te kesaj detyre eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe ate per kontrollet periodike te ushtruara.

KREU 5
PRISHJA DHE RI-ORGANIZIMI I SHOQERISE
NENI 18

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Shoqeria konsiderohet e shperndare kur:

- a. Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar e shoqerise
- b. Me vendimet e asamblese se Ortakeve
- c. Me hapjen e procedurave te falimentit
- d. Nese nuk zhvillon aktivitet tregetar per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 Per Qendren Kombetare te Regjistrimit,
- e. Me vendim gjykate.

NENI 19
RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te ligjit mbi shoqerite tregtare.

ART. 20
KLAUZOLA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Ortaket dhe administratoret e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, nuk mund te mbajne pozicionin drejtues apo te jene te punesuar ne nje shoqeri qe ushtron aktivitet ne te njejten fushe me te paren. Ndalimi i pikes 1 mund te anulohet ne asamblene e pare te pergjithshme me ³/₄ e votave ne sipas dispozitave te neneve 87 dhe 145 te ligjit per shoqerite tregtare.



NENI 21
LEGJISLACIONI

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me statutin, legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

NENI 22
MOSMARREVESHJET

Per mosmarrveshjet midis ortakeve te shoqerise, ose shoqerise me te tretet, gjykata kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata Shqiptare.

Ky akt, u redaktua ne 4 kopje ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhen italjane, me vlere te njejte ligjore.

ORTAKET THEMELUES

BIAGIO MANCUSO

GIOVANNI IACONETTI

GIAMBATISTA LONGO

